



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**

**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. gug /2023

Datë: 30 nëntor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1.32 dhe nenit 16 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 28 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe në bazë të Memorandumeve të Mirëkuptimit të lidhura në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ambasadës Norvegjeze, në takimin e mbajtur më datë 30 nëntor 2023, nxjerr këtë:

**VENDIM**

- I. Aprovohet propozimi i Komisioni për Administrimin e Prokurorive për themelimin e Grupit Punues të përdoruesve për prokurori në kuadër të Projektit TIK/SMIL i datës 09 nëntor 2023.
- II. Themelohet Grupi Punues i Përdoruesve të SMIL-it për prokurori në këtë përbërje:
  1. Znj. Sevdije Morina, prokurore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit – Kryesuese;
  2. Z. Ardian Hajdaraj, anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës – anëtar;
  3. Z. Arben Ismajli, prokuror në Prokurorinë e Apelit – anëtar;
  4. Z. Burim Çerkini, prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës – anëtar;
  5. Z. Admir Shala, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren – anëtar;
  6. Z. Eset Rama, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë – anëtar;
  7. Znj. Sebahate Sinani, prokurore në Prokurorinë e Apelit – anëtare.
- III. Anëtarët e Grupit Punues të cekur në paragrafin II të këtij vendimi kanë përgjegjësitë si në vijim:
  1. Të monitorojnë zbatimin e plotë të SMIL-it në të gjitha prokuroritë;
  2. Të ofrojnë këshilla gjatë procesit të avancimit (dizajnimit të proceseve të punës) të Sistemit të Menaxhimit të Lëndëve në prokurori;

3. Të aprovojë kërkesa të cilat do të zhvillohen, në mënyrë që ato të përfshihen në sistemin SMIL për prokurori;
4. Të caktojë prioritetet e avancimit dhe zhvillimit të SMIL me funksione të reja;
5. Të rekomandojë në KPK nxjerrjen e akteve nënligjore të cilat do të mbështesin Sistemin për Menaxhimin e Lëndëve;
6. Të monitorojë kualitetin e të dhënave dhe t'i rekomandojë KPK-së veprimet të cilat duhet të ndërmerren;
7. Të rekomandojë në KPK inicimin e amendamentit të ligjeve të cilat mund të jenë pengesë e vënies si dhe paraqet rekomandime për avancim të procesit;
8. Të propozojë në KPK forma-modele të raporteve statistikore për përdorim (të njëjtat pas aprovimit zhvillohen në SMIL).

IV. Obligohen Anëtarët e Grupit Punues të cekur në paragrafin I të këtij vendimi që për punën e tyre ti raportojnë Komisionit për Administrimin e Prokurorive.

V. Anëtarët e Grupit Punues duhet të jenë në komunikim të vazhdueshëm me prokuroritë e Kosovës, me qëllim të mbledhjes së sugjerimeve nga kolegët dhe në këtë mënyrë, sa më shumë që është e mundur, të mbajë stafin e prokurorive të përfshirë në projekt.

VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet KPK/Nr.119/2016 dhe KPK/Nr.120/2016 të datës 31 mars 2016.

VII. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.

VIII. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

  
 Jetish Maloku  
 Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Komisionit për Administrimin e Prokurorive;
- Sekretariatit dhe NJSHP;
- Arkivit të KPK-së.